



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.538/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Milena Đerić dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Gentiana Krasniqi duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Flori Hakaj me vendbanim në Gjermani, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 27.08.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.538/2021 i paraqitur nga Flori Hakaj me vendbanim në Gjermani, me të cilin kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Me datën 26.08.2021, PZAP-i ka pranuar një apel përmes email-it nga Flori Hakaj me vendbanim në Gjermani, në të cilën pretendohet se shkak i apelit është mos përfshirja në listën e votuesve jashtë Kosovës nga KQZ-ja.

Parashtruesi i apelit ka bashkangjitur sms e kthyer nga KQZ se ka pranuar emailin, formularët dhe dokumente identifikuese të tij si dëshmi lidhur me pretendimet në apel.

Me datë 26.08.2021 PZAP ka parashtruar kërkesë për përgjigje pranë KQZ për ankesën A.nr.538/2021 të parashtruar nga Flori Hakaj.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve KQZ, brenda afatit kohor ka paraqitur përgjigje në kërkesë në të cilën ka bashkangjitur edhe tabelën rreth ankesës në të cilën ka theksuar se brenda afatit ligjor ka pranuar aplikimin për regjistrim për votim nga Flori Hakaj përmes emailit, i cili ka dërguar vetëm aplikacionin me të cilin nuk dëshmojnë kriteret ligjore për tu përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës (nuk ka dëshmuar kriterin e identitetit dhe as kriterin ligjor për tu përfshirë në listën e votueve). Krahas kësaj përgjigje KQZ ka bashkangjitur edhe emialin e dërguar nga Flori Hakaj të datës 23.08.2021 përmes së cilës vërtetohet se Flori Hakaj ka konfirmuar se aplikimit nuk i ka bashkangjitur dokument identifikimi.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e apelit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i pabazuar pasi që parashtruesi i apelit gjatë aplikimit të tij për regjistrim për votim jashtë Kosovës, ka dërguar vetëm aplikacionin për regjistrim duke mos dëshmuar as kriterin e identitetit dhe as kriterin ligjor për tu përfshirë si votues në listën jashtë Kosovës ashtu që aplikacionit nuk i ka bashkangjitur kopjen e dokumentit të vlefshëm të identifikimit përmes së cilës do të dëshmonte identitetin e tij dhe faktin se është shtetas i Republikës së Kosovës andaj edhe nuk i ka plotësuar kriteret të cilat kërkohen në bazë nenit 5.1 pika a) të LZP-së ku përcaktohet: **“çdo person ka të drejtë për të votuar nëse është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil të Kosovës”**, si dhe dispozita e nenit 3.1 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: **“votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedh fletëvotimin për zgjedhjet në qoftë se është regjistruar si banorë i përhershëm i Kosovës në Regjistrin Qendror civil”** dhe dispozita e nenit 3.3 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se:

3.3 Personi i cili ka për qëllim të hedhë votën për Votim Jashtë Kosovës...do të regjistrohet në KQZ si votues jashtë Kosovës duke dorëzuar:

a) formularin për Aplikim/Regjistrim për votim jashtë Kosovës, kopja e së cilës është bashkangjitur si Shtojcë II, dhe,

b) dëshminë e dokumentacionit të identitetit dhe që ai ose ajo i plotëson kriteret ligjore për të drejtën për të votuar në pajtim me nenin e LZP-së dhe të bashkangjiten dokumentet e fotokopjuara siç janë të renditura në Shtojcën III. të kësaj rregulle,

Nga shkresat e lëndës Paneli, vlerësoi se parashtruesi i apelit në momentin e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës dosja e tij nuk ka qenë e kompletuar dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara siç parashihet me dispozitat e nenit 5.1 pika a) të LZP-së dhe të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara, andaj me të drejtë është refuzuar nga ana e KQZ-së.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 538/2021 më datën 27.08.2021

Kryesuesi i Panelit
Faton Ademi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.